



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.642/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Kymete Kicaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e kandidatit për deputet Agron Kuçi nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave nga jashtë Kosovës -votave me postë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa A.nr.642/2025 e datës 18.03.2025, e parashtruar nga kandidati për deputet Agron Kuçi nga radhët e subjektit politik AAK, e paraqitur kundër KQZ respektivisht për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave jashtë Kosovës-votave me postë për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 18.03.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën nga kandidati për deputet Agron Kuçi nga radhët e AAK-së në të cilën pretendon , për pranimin dhe hapjen e fletëvotimeve të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ-së, përkatësisht Qendra e Votimit;

VP/31 — Junik - 31/VP. Duke u bazuar në informacionet e mbledhura dhe të bazuar nga diaspora për keqpërdorimet dhe shkeljet ligjore me rastin e dërgimit të organizuar të fletëvotimeve jashtë Kosove nga aktivistë të Shoqatës, "Sali Çekaj" për votuesit e Komunës së Junikut, në Qendrën e Votimit me nr; VP/31 — Junik - 31/VP, që përfshijnë subjektet politike të ndryshme, me theks të veçantë, LDK, kerkojmë nga PZAP që të marrë vendim për hapjen e atyre fletëvotime përmes postës, e të cilat paraprakisht janë refuzuar dhe shpallë të pavlefshme, me arsyetim të parregullsive të panjohura për ne, si degë e AAK-së dhe bashkëkombasit Junikas në diasporë. Së këndejmi, në kuptim të rerspektimit të ligjit, eliminimit të dyshimeve të bazuara mirë, kerkojmë që të hapen, numërohen dhe të rivlerësohen në mënyrë reale dhe objektive të gjitha fletëvotimet të cilat janë shpallë të pavlefshme në përputhje me vendimin e PZAP, ku të njëjtat pastaj, do të hyjnë në rezultate për subjektet politike dhe kandidatët

Paneli pas vlerësimit të ankesës, konstaton se:

- Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesë në PZAP me datë 18.03.2025, me të cilën pretendohet për parregullesi dhe keqperdorime me rastin e dërgimit të organizuar të fletëvotimeve jashtë Kosovës duke kërkuar hapjen e fletëvotimeve të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ-së, përkatësisht Qendra e Votimit; VP/31 — Junik - 31/VP.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se ankesa është e parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e saj, pasi që në njoftimin e KQZ-së i publikuar në web faqen e saj ndër të tjera thuhet se "...Prishtinë, 04 mars 2025, 16:00 – Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është përmbyllur numërimi i fletëvotimeve nga votimi me postë jashtë Kosovës, i cili kishte filluar me 28 shkurt..." ndërsa pala ankuese gjegjësisht kandidati Agron Kuqi nga subjekti politik AAK, ankesën e ka dorëzuar në poste me date 13 mars 2026 ndërsa ne PZAP është pranuar me datën 18 mars 2025, që do të thotë se ankesa për këto pretendime është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor prej 48 orëve bazuar në nenin 105 paragrafi 1 i LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se : *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar"*.

Paneli gjeti se e njëjta është ushtruar pas afatit ligjor, respektivisht pothuajse që i bie 8 dite pas afatit ligjor dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.642/2025 datë 18.03.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.